



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

### V E N D I M

**Nr. 76, Datë 07/05/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 74, datë 22.04.2021, e znj. I.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe për “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Elda sh.p.k.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesja I.B. punon prej 22 vitesh pranë Elda sh.p.k. Ajo pretendon se shoqëria pranë së cilës punon, është në shkelje të kontratës së saj individuale të punës. Ankuesja pretendon se në muajin mars 2021, vjehrra e saj ka ndërruar jetë dhe Elda sh.p.k. nuk i ka dhënë leje të paguar prej 5 (pesë) ditësh sikurse parashikohet në Kodin e Punës, por vetëm për 4 (katër) ditë. Njëkohësisht, ankuesja pretendon se edhe në muajin dhjetor 2020 ka kërkuar lejen vjetore, e cila nuk i është paguar e plotë.

Për sa më sipër, znj. I.B. pretendon se shkelja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit përbën diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Ndër të tjera, ajo sqaron se është ankuar edhe më parë pranë KMD-së, nëpërmjet ankesës nr. 80, datë 22.07.2020, ankesë kjo e paraqitur nga një grup personash kundër Shoqërisë “Elda Sh.p.k” dhe ekonomistes O.D., në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, pasi nuk kanë përfituar pagën e luftës gjatë periudhës së fillimit të pandemisë Covid-19. Për këtë ankesë, Komisioneri është

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

shprehur me vendimin nr. 95, datë 26.08.2020, ku procedura administrative është deklaruar e përfunduar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar hetimi administrativ.

Ankuesja pretendon se reagimi i shoqërisë lidhur me sa më sipër, mund të jetë edhe pasojë e ankesës së saj, të mëparshme pranë KMD-së.

#### **A. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri.**

Pas analizimit fillestar, u gjykua që ankesa duhet të plotësohej me informacion të mëtejshëm. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankueses<sup>3</sup> me e-mail, në datën 27.04.2021, ku iu kërkua informacioni i mëposhtëm:

1. Të vërtetohet shkaku i pretenduar i diskriminimit “gjendja ekonomike”, për të cilën pretendohet diskriminim. Informacioni konsiston në të dhëna konkrete që dëshmojnë për gjendjen dhe nivelin ekonomik të ankeses dhe familjes së saj. Të jepet informacion mbi numrin e anëtarëve të familjes së ankueses, si dhe mbi faktin nëse bashkëshorti apo pjesëtarë të tjerë të familjes janë të punësuar, ose janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë. Informacion mbi pagën e ankueses dhe të bashkëshortit. Informacion nëse familja trajtohet ose është trajtuar më parë me ndihmë ekonomike;
2. Kopje e certifikatës së vdekjes së vjehrrës së ankueses;
3. Informacion mbi faktin, nëse ankuesja ka depozituar pranë punëdhënësit ndonjë ankesë për mosdhënien e plotë të lejes për fatkeqësi familjare, si dhe për mos kryerjen e pagesës së plotë të lejes vjetore. Informacion mbi periudhën kohore përgjatë së cilës ankuesja ka kryer lejen vjetore dhe numrin e ditëve të kësaj leje. Kopje e kërkesës së ankueses për leje vjetore.
4. Informacion nëse veprimet e padrejta, të Elda sh.p.k., të pretenduara nga ankuesja, janë drejtuar vetëm ndaj saj apo edhe ndaj punonjëseve të tjera të kësaj shoqërie, që kanë depozituar edhe më herët ankesë pranë KMD-së.
5. Informacion nëse ka patur edhe punonjëse të tjera ndaj së cilave janë reflektuar problematika të tilla nga ana e shoqërisë.

---

<sup>3</sup>Në mungesë të adresës së e-mailit të ankueses, e-maili iu drejtua Zyrës Rajonale Korçë, të KMD-së, e cila përcolli informacionin përkatës.

- Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, në datën 29.04.2021, u dërgua përgjigjia përkatëse, e cila konsistonte në:
  - a) çertifikatën familjare të ankueses, sipas së cilës familja e znj. I.B. përbëhej nga ankuesja dhe bashkëshorti i saj;
  - b) çertifikata e vdekjes së vjehrrës së ankueses, ku rezulton se ajo ka ndërruar jetë në muajin mars 2021;
  - c) Vërtetim për llojin dhe masën e pensionit të bashkëshortit të ankueses;

Në e-mailin e dërguar në adresë të KMD-së sqarohet se ankuesja nuk ka depozituar ankesë pranë punëdhënësit për mosdhënien e plotë të lejes për fatkeqësi familjare, si dhe për mos kryerjen e pagesës së plotë të lejes vjetore. Njëkohësisht, KMD bëhet me dije se ankuesja ka kryer 2 javë të lejes vjetore, në muajin dhjetor 2020. Elda sh.p.k. nuk i paguan ditët e festave zyrtare për të gjithë punonjësit.

**B. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 74, datë 22.04.2021, e znj. I.B., KMD konstatoi se:**

Në ankesën nr. 74, datë 22.04.2021, e znj. I.B., pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe për “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Elda sh.p.k. Nga analizimi i ankesës së depozituar rezulton se ankuesja është punonjëse e shoqërisë dhe nuk ka përfituar të plotë lejen 5 ditore, që jepet në rastet e fatkeqësisë familjare, pasi punëdhënësi i ka dhënë leje të paguar vetëm për 4 ditë, si dhe nuk i është paguar e plotë leja e vitit 2020, prej 2 javësh, që ka marrë në muajin dhjetor 2020. Ankuesja pretendon se shkelja e kontratës së saj të punës përbën diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, si dhe për shkak se ajo ka paraqitur me herët ankesë pranë KMD.

**Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*etnisë*”, “*moshës*” dhe “*për çdo shkak tjetër*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pikat 1, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e ndryshuar. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

Për sa më sipër, rezulton se ankuesja nuk ka depozituar pranë KMD-së asnjë akt që të vërtetojë pretendimet e saj, lidhur me trajtimin e padrejtë e disfavorizues ndaj së cilit ajo është ekspozuar. Znj. I.B. nuk ka depozituar në cilësi prove kërkesën për leje 5 ditore drejtuar punëdhënësit në raste fatkeqësie familjare apo refuzimin e punëdhënësit që në vend të 5 ditëve asaj do t'i jepeshin vetëm 4 ditë leje, kërkesën për leje vjetore në vitin 2020, apo dokumentacion tjetër provues të pretendimit të saj. Në rastin konkret, Komisioneri nuk gjen indicie për të nisur një hetim administrativ ndaj Elda sh.p.k. Çdo pretendim i ankueses mbështetet në dëshmi verbale, por jo në prova konkrete, shkresore.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura

gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Për sa më sipër, shkakun i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit dhe si i tillë duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Lidhur me shkakun e diskriminimit të pretenduar, i cili është “gjendja ekonomike”, Komisioneri i ka kërkuar ankueses informacion që të provojë shkakun në fjalë. Sipas informacionit të administruar rezulton se familja e ankueses përbëhet nga ajo dhe bashkëshorti i saj, i cili është pensionist. Ankuesja punon prej 22 vitesh pranë Elda sh.p.k. si punonjëse fasonerie. Ankueses i është kërkuar informacion, për efekt të hetimit administrativ, mbi masën e pagës së saj, informacion i cili nuk është përcjellë pranë KMD-së.

Ajo pretendon diskriminim nga ana e Elda sh.p.k. për shkak të gjendjes ekonomike, por niveli i gjendjes së saj ekonomike është i paprovuar dhe lidhja ndërmjet gjendjes ekonomike dhe veprimeve të pretenduara diskriminuese ndaj saj nga ana e Elda sh.p.k. nuk evidentohet në asnjë rast. Familja e ankueses nuk trajtohet me ndihmë ekonomike dhe asnjë anëtar i familjes së saj nuk është punëkërkuar i papunë. Ankuesja nuk ka argumentuar dhe sqaruar në asnjë rast, se përse veprimet e pretenduara si diskriminuese të Elda sh.p.k. lidhen me gjendjen e saj, ekonomike.

Një tjetër shkak diskriminimi i pretenduar nga ana e ankueses është edhe fakti që më herët ajo dhe 19 punonjëse të tjera të Elda sh.p.k. kanë depozituar pranë KMD-së, ankesën nr. 80, datë 22.07.2020 kundër Shoqërisë “Elda Sh.p.k” dhe ekonomistes O.D., në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, pasi këto punonjëse nuk kanë përfituar pagën e luftës gjatë periudhës së fillimit të pandemisë Covid-19. Për këtë ankesë, Komisioneri është shprehur me vendimin nr. 95, datë 26.08.2020, ku procedura administrative është deklaruar e përfunduar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar hetimi administrativ, pasi punonjëset ankuese e përfituan pagën e luftës.

Në ankesën nr. 74, datë 22.04.2021, znj. I.B. pretendon se ajo diskriminohet nga punëdhënësi, pasi është ankuar më parë pranë KMD-së. Lidhur me këtë shkak, KMD i kërkoj informacion ankueses, nëse ndonjë prej 19 punonjëseve të tjera, që kanë qenë ankuese, sikurse znj. I.B., kanë patur problematika të ngjashme me punëdhënësin Elda sh.p.k., pasi këto punonjëse janë në kushte të njëjta me ankuesen. Ankuesja nuk ka dhënë informacion mbi këtë çështje.

Përveç sa më sipër, ankuesja nuk ka depozituar asnjë provë dhe fakt konkret, që të provojë situatën për të cilën pretendon diskriminim. Në këto kushte, KMD vë në dukje faktin se për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ. Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për shkaqe

të provuara diskriminimi, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: *“është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa e znj. I.B. nuk pranohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 7, nenin 12, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 74, datë 22.04.2021, së znj. I.B., pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Punësim  
Shkak- gjendja ekonomike dhe për çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit - Mospranim